

SEMANTIC AND GRAMMATICAL TIES OF PHRASEOLOGICAL COUPLES THROUGH SYNTAXICAL STRUCTURES OF SPEECH (FROM THE SOCIO-LINGUISTIC POINT OF VIEW)

LIDHJET SEMANTIKE E GRAMATIKORE TË ÇIFTEVE FRAZELOGJIKE NË NDËRTIMET SINTAKSORE TË LIGJËRIMIT TË FOLUR, NË KËNDVËSHTRIMIN SOCIOLINGUISTIK

ELONA (BIBA) ÇEÇE

Universiteti "Fan S. Noli", Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
Shqipe, Korçë, ALBANIA
elona_biba@yahoo.com

AKTET V, 4: 624-629, 2012

PËRMBLEDHJE

Studimi i marrëdhënieve që vendosen mes njësive frazeologjike në lidhje dyshe, në të njëjtën strukturë sintaksore paraqet mjaft interes, pasi kemi të bëjmë me një dukuri që bart jo vetëm vlera kuptimore, por edhe stilistike e gramatikore. Materialin faktik, të mbledhur përmes intervistimeve në qytetin e Korçës dhe rrethinat e tij, e kemi interpretuar nga dy këndvështrime.

I. Këndvështrimi gramatikor, i cili na dikton ndarjen në dy kategori:

1. Çifte frazeologjike me marrëdhënie kuptimore, ku përfshihen: çiftet sinonimike, antonimike dhe me lidhje asociative.

2. Çifte frazeologjike me marrëdhënie gramatikore, ku përfshihen: çifte frazeologjike me raporte nënrenditëse; çifte frazeologjike të lidhura sipas një regjimi gramatikor.

Mund të themi, se funksioni që ka një denduri më të madhe përdorimi është ai kallëzuesit a kryegjymtyrës foljore, p.sh.: funksioni i kallëzuesit të thjeshtë foljor; i kallëzuesit të përbërë foljor dhe funksioni i pjesës emërore të kallëzuesit të përbërë emëror.

II. Në këndvështrimin sociolinguistik, përdorimi i njësive frazeologjike lidhet me një bashkësi etnokulturore që dëshmon diversitet të sjelljes gjuhësore të kushtëzuar nga faktorë natyrorë, si: mosha, gjinia, grupi etnik dhe nga faktorë shoqërorë, si: klasa ekonomiko – shoqërore dhe niveli i arsimit. Përmes kësaj karakteristike të qenësishme të të folurit folësit synojnë të kenë një ndikim të fortë të bashkëbiseduesit, pra thënia realizon përveç funksionit referencial edhe funksionet e tjera të gjuhës: atë shprehës, mbartës, metalinguistik, poetik dhe atë faktik, d.m.th. të gjithë skemën e funksioneve të gjuhës të njohur nga sociolinguistika bashkëkohore.

Përdorimi i çifteve frazeologjike në strukturat sintaksore përbën një teknikë ligjërimore.

Fjalët kyçe:: çift, frazeologjik, sjellje, gjuhësore, teknikë, ligjërimore

SUMMARY

The study of the relations established between double phraseological units found in the same syntactic structure presents great interest, since we are dealing with a phenomenon that conveys not only semantic values, but also stylistic and grammatical ones. We interpreted the factual material, gathered through interviews in Korca and its surroundings, according to the following two perspectives:

I. The grammatical perspective, which requires us to divide them into two categories:

1. Pairs of phraseological units presenting semantic relationships, including synonymous, antonymous phraseological units, as well as the ones establishing associative links.

2. Pairs of phraseological units establishing grammatical relationships including: phraseological pairs presenting relationships of subordination; phraseological pairs connected according to a grammatical regime.

We can say that the most frequently used function is that of the predicate or verbal predicate, such as the function of the simple verbal predicate, the compound verbal predicate and the function of the nominal part of the compound nominal predicate.

II. In sociolinguistic perspective, the use of phraseological units is associated with an ethno-cultural community that demonstrates a diversity of linguistic behavior conditioned by natural factors such as age, gender, ethnic group and by social factors such as social and economic class and educational level. Through this inherent characteristic of speech, speakers tend to have a strong influence on their interlocutors; thus a statement carries the referential function in addition to other functions of language: the expressive, metalinguistic, poetic and factual, i.e. the overall scheme of language functions recognized by contemporary sociolinguistics. The use of phraseological pairs in syntactic structures constitutes a discursive technique.

Key words: phraseological, pairs, linguistic, behaviour, speech, technique.

1. HYRJJE

Në këtë kumtesë kemi dashur të zbulojmë se ligjërimi i folur kushtëzohet nga faktorë natyrorë, si: moshë, gjinia, grupi etnik dhe nga faktorë shoqërorë, si: klasa ekonomiko – shoqërore dhe niveli i arsimit, pasi gjuha nuk është thjesht një mjet komunikimi, por shpreh një marrëdhënie shoqërore.

Kryesisht jemi përqendruar tek faktori “gjini”. Ekzistenca e një *ligjërimi femëror*, (fakt i njohur ky edhe në studimet sociolinguistike në rang botëror apo në rang kombëtar, përmendim këtu: prof. Eqrem Çabej, prof. Gjovalin Shkurtaç), përligjet nga ekzistenca e veçorive gjuhësore që prekin rrafshin fonetik, gramatikor, leksikor, stilistikor.

Në këtë kumtesë i jemi referuar rrafshit leksikor dhe atij gramatikor. Zbulimi i këtyre veçorive gjuhësore na ka çuar në një përfundim të rëndësishëm: ligjërimi femëror ka statusin e një *kategorie të vecantë të folurit*. Përmes këtyre rezultateve konkrete, vërtetojmë gjithashtu, edhe pasurinë e gjuhës së gjallë të popullit, si dhe tezën e konservatorizmit në gjuhë, që haset kryesisht te grupi shoqëror i femrave. Ky punim i përket nivelit mikrosociolinguistik, pra sociolinguistikës së zbatuar.

Ky fakt ligjërimor (i parë nga këndvështrimi sociolinguistik) lidhet me një bashkësi etnokulturore konkrete, pikërisht me bashkësinë etnokulturore të Korçës dhe rrethinave të saj, si: Mborje, Drenovë, Voskop, Kamenicë, Dardhë, Voskopojë, Boboshticë, Bulgarec, Barç. Prandaj për mbledhjen e materialit leksiko-frazeologjik kemi hartuar një anketë sociolinguistike. Natyrisht, *etnografia* (njohja e mënyrës së jetesës, rriteve,

zakoneve) ka shërbyer si bazë për hartimin e anketës. Këto anketa u aplikuan në 260 persona, nga të cilët vetëm 25% janë meshkuj. Jemi kujdesur që të ketë një raport të drejtë në shpërndarjen e këtyre anketave, konkretisht për treguesit: fshat-qytet; persona të besimit mysliman – persona të besimit ortodoks; të rinj – moshë e mesme; të moshuar; të arsimuar - të paarsimuar. *Duke krahasuar* tiparet ligjërimore, *duke i analizuar* ato në dy rrafshë: në rrafshin kuptimor dhe në atë gramatikor, si dhe *duke u bërë një interpretim sociolinguistik*, u përpoqëm të vërtetojmë veprimin e ndryshorit “gjini” në ligjërimin e folur.

Si rezultat i anketimit doli se në ligjërimin e folur, sidomos në ligjërimin e femrave hasen shpesh raste të përdorimit të dy njësive frazeologjike pranë e pranë, në lidhje dyshe (çifte). Natyrisht, studimi i këtyre marrëdhënieve është me interes për të parë mënyrat e lidhjeve të njësive frazeologjike e dukurive semantike që ngërthehen në to. Gjithashtu, duhet theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me një dukuri që bart jo vetëm vlera kuptimore, por edhe stilistike. Në përdorimin e njësive frazeologjike në lidhje dyshe nga këndvështrimi gramatikor na diktohet ndarja në dy kategori:

(1) Sipas marrëdhënieve kuptimore, ku përfshihen: çiftet sinonimike, antonimike dhe me lidhje asociative.

(2) Sipas marrëdhënieve gramatikore, ku përfshihen: çifte frazeologjike me raporte nënrenditëse ; çifte të lidhura sipas një rregjimi gramatikor.

2. ÇIFTE FRAZEOLGJIKE ME AFRI KUPTIMORE OSE ÇIFTE SINONIMIKE

Në këto raste është e kuptueshme: njësitë frazeologjike që përdoren në çifte, kanë vlera foljore, emërore, ndajfoljore. Synimi i përdorimit në çifte është të sjellë nuancat e holla kuptimore e ngjyresat më të diferencuara stilistike, emocionuese. Sipas këtij funksioni kryesor dallohen brenda tyre disa nëngrupe:

(a) Kur njësia e dytë frazeologjike sjell përforsim të veprimit nëpërmjet shkallëzimit të tij, si p. sh: djali u rrit *si hardhi e krasitur* (hodhi shtat) e u bë *sa një lisnik* (u bë i madh).

Tani atij *i ranë opingat* (u plak) dhe *e shiu arën e vet* (është në ditët e fundit).

Tani *ka dalë në mezhde* dhe *i mban koka erë hallvë* (iu afrua vdekja).

Ky *e hëngri çyrekun* (u plak) dhe *i mban koka erë* dhe (iu afrua vdekja).

S'po bën *as përpjetë as tatëpjetë* (s'ka shenja përmirësimi), siç duket *e ka perin të shkurtër* (do të vdesë së shpejti).

(b) Çifte sinonimike ku njësitë frazeologjike kanë kuptim të afërt, por ndryshojnë nga densiteti i ngarkesës emocionuese. Njësia frazeologjike që luan rolin e identifikuesit semantik qëndron gjithnjë para. Përdorimi i këtyrë çifteve ka thjesht funksion semantik, por të rrafshit emocionues.

Eh, *s'di dhia ç'është tagjia, s'di këndesi të mbajë brekë*.

Ky *nuk ngroh vezë* (lëviz shumë), *si kalë pa fre* është (i papërmbytur).

Vjen ajo *ia thyen kërcinjtë* (e rreh), *ia jep mishtë në dorë* (e rreh shumë).

I ziu, *e ka kokën qyp* (është kokëtrashë), *mbeti dy në majë e tre në degë* (nuk ka pjekurinë e duhur).

(c) Në kontekste të caktuara përdoren pranë njërive frazeologjike edhe fjalë, të cilat janë sinonime me to. Këto fjalë përdoren si identifikues semantikë dhe jo për të shpjeguar njësinë. Fjala s'ka ngjyrim emocionues, ndërkohë që atë e bart njësia frazeologjike. P.sh.: E kontrollon, *i kërkon llogari*; E rrahu, *e bëri qeshqek*; Është shumë i çrregullt, *e pëlcet si lopa bajgën*; Është i prapë, *s'lë dy gurë bashkë*.

(d) Në disa raste bashkëpërdoren njësi frazeologjike që në përdorimin e përgjithshëm

kanë në thelb kuptim të kundërt, prandaj brenda kontekstit njëra njësi frazeologjike del në trajtën mohuese dhe kjo realizohet me anë të pjesëzave mohuese, në mënyrë që të vihet në marrëdhënie sinonimike me të parën. P. sh.:

Kështu si u bë ky nuk duhet *t'i hapësh syrin*, por *t'i heqësh një dru të mirë*.

Që të ketë vlerë, jo *t'i bësh kurrizin më të butë se barkun*, por *t'i japësh një dackë të mirë* që t'i vlejë për tërë jetën.

3. ÇIFTE FRAZEOLGJIKE ME MARRËDHËNIE ANTONIMIKE

Antonimia në frazeologji krijohet mes dy njërive që kanë ngjyrim stilistik – emocionues të kundërt. Mundësia e lindjes së marrëdhënieve antonimike në dy njësi frazeologjike brenda një segmenti ligjërimor krijohet ngaqë kuptimi i tyre ka karakter cilësues – vlerësues. P.sh.:

Ndryshojnë shumë ata të dy: ajo është si hënë e plotë, ai është si i shtënë.

Asaj s'i ndihet zëri, ai grindet edhe me ujin.

Ajo është *thërrime në tagar* (e ndershme), ai *lule më lule* (nuk është besnik).

E vjehrra *barkun hambar*, ajo i *vë fre pleshtit*.

Asaj *s'i del gjë nga dora*, ai *fito pesë e prish gjashtë*.

4. Çifte frazeologjike me raporte nënrenditëse shkak – pasojë, kusht – rrjedhojë

Këto çifte frazeologjike, sipas funksioneve që kanë në fjali, si e tregon edhe nëntitulli, mund të realizojnë: (a) raporte shkak-pasojë dhe (b) raporte kusht -rrjedhojë.

(a) Çifte të kësaj natyre dallohen lehtë ngaqë këto raporte shprehen me mjete të ndryshme gjuhësore, siç janë fjalët: se, sepse etj. Lidhja e njërive frazeologjike në çift sipas raporteve **shkak – pasojë** është lidhje më e zakonshme që vihet re në këtë grup. P.sh.:

Atij *s'ia ha qeni shkopin*, *se ka parë shumë* (është i zoti se ka përvojë të gjatë).

Tundet e shkundet, *se i erdhi e mira në derë*.

S'bën prokopi ai njeri, *se fiton pesë e prish gjashtë*.

S'e ka për gjë ajo, *se është portë më portë* (s'i bën përshtypje se është bredharake, llafazane).

(b) Raportet kusht – rrjedhojë dallohen edhe nga përdorimi i lidhëzës: po, p.sh.: *Po të kisha vepruar me mend nuk do më sillte rrotull tani.*

Po të ra në pjesë, bëje barkun hambar.

Po foli kodra pas bregut, mos ia vër veshin.

Po e mbylle një sy, bën udhë e mbi udhë.

Po e le të lirë nuk sillet sipas normave.

Në kushte të tilla raportet shkak – pasojë, kusht – rrjedhojë te njësitë frazeologjike janë të lidhura aq ngushtë, sa duket sikur ke të bësh me proverba.

5. Çifte frazeologjike të lidhura sipas një regjimi gramatikor

(a) Në çifte të tilla njësia e parë del në rolin e kryefjalës, ndërsa e dyta del në rolin e kallëzuesit:

Me laçkë e plaçkë i bëri rrush e kumbulla.

Me soj e sorollop u bënë def.

Djallit me birër ia ha kokën me të mirë.

(b) Njësia e parë mund të jetë në rolin e kallëzuesit dhe e dyta në rolin e kundrinorit:

Më zuri goja lesh me të birin e njerëz (u lodha së foluri me këtë njeri të llastuar).

M'u dogj barku për të birin e babait (nuk shqetësohem për një njeri që s'e kam të afërt).

E bëri qeshqek qenin e lëshuar nga zinxhiri (e rrahu shumë dikë që është i papërmbytur).

6. Çifte eufemizmash

Eufemizmat mund t'i konsiderojmë si "repartin kryesor" në të folmen e femrave, dhe dëshmojnë, siç shprehet prof. Gjovalin Shkurtaç, tryshinë e shoqërores mbi gjuhësoren. (Shkurtaç, 1999: 241). Dihet se eufemizmat paraqiten si fjalë, togfjalësha apo pjesë fjali që përfshihen në strukturat sintaksore me funksione të ndryshme: I ra e paemra; **Merhumi** na i la punët pa rregulluar (kryefjalë).

Kishte sëmundje të keqe, **të paemrën** (kundrinor). Në këtë rast janë sinonime dy eufemizma.

Mund të jesh... e rëndë (pjesë emërore e kallëzuesit emëror). Në këtë ndërtim mund të themi se kemi një çift të tipit "tautologjik", ku pauza nënkupton fjalën "barrë", "shtatzënë". S'është më ai që e bëri sheshin breg, "ai që ndjesë

pastë" (pjesë e nënrenditur përcaktore). Këtu ndërtimi ka një ngarkesë të madhe emocionale, pasi çifti është formuar nga një eufemizëm me ngjyrim keqësues dhe një eufemizëm me ngjyrim pozitiv, por që ngarkohet negativisht nga konteksti i përdorimit.

7. Pseudoçiftet me bazë "mallkimet"

Interesante në ligjërim është përfshirja e mallkimeve në strukturat sintaksore. Dell Hajmesi e ka quajtur "Ethnografi of Speech", "etnografi e të folurit" atë çka pasqyrohet në kodin gjuhësor. Pikërisht, mallkimet mund t'i konsiderojmë si një "zakon shoqëror", sepse ato jo se nuk njihen nga meshkujt, por nuk përdoren prej tyre duke qenë se ato identifikohen me të folurën e grave. Dihet që për nga ndërtimi ato janë fjali dëshirore. Nga anketimet e bëra mund të themi se vihen re këto raste:

(1) Shoqërimi i tyre me pasthirrma:

A, m'u bëfsh kurban!

U, mos u bëfsh!

(2) Përsëritja e foljes - kallëzues dhe lidhja e tyre me përemrin lidhor që.

Në këtë rast ato kanë funksionin e pjesës së nënrenditur përcaktore, sepse nënkuptohet (elipsohet vepruesi) që shërben si paraprijës. Mud të themi se në këto raste kemi "pseudoçifte".

- Ç'ke bërë kështu (moj ti) që u bëfsh lëmsh, u bëfsh!

- Ç'ke bërë kështu që u bëfsh lëmsh, u bëfsh!

- Ku ishe lojte, që lojç majë shelgut, lojç!

- A gojësprijë, gojë, që të lidhsha buzën me shami të lidhsha!... të hëngërt flama të hëngërt! ... t'u thaftë dora, t'u thaftë!; të marrtë djalli, të marrtë!

... të hëngsha grurin, ... të hëngsha!; ... që mos bëfsh hair, mos bëfsh!; ... që mos ardhsh i gjallë, mos ardhsh!; ... që mos bëfsh përpjetë, mos bëfsh!.

8. Çiftet që formohen midis një shprehjeje të figurshme dhe një fjale a togu neutral

Shpesh në ligjërim vërehet përdorimi i shprehjeje të figurshme gjuhësore.

Po të analizojmë të folurit, vihet re se shumë prej shprehjeve janë me pejardhje metaforike.

(1) **Metaforat** janë të ndërtuara zakonisht mbi bazën e një gjymtyre, e cila ka ndjekur procesin e leksikalizimit nga figura letrare te figura gjuhësore, drejt kuptimit të ri leksikor. Po sjellim disa grupe sintagmash, të cilat kanë një gjymtyrë të përbashkët dhe përdoren kryesisht në ligjërimin e grave.

Me emrin **ditë**: *i kaloi ditët; merr ditët; i bëri ditët; të ketë ditët; prenë ditën.*

Me emrin **qumësht**: *i vjen qumështi; i ra qumështi; i iku qumështi; i trembet qumështi; është me qumësht.*

Me emrin **zi**: *mban zi; ndjell zi; prish zinë; çel zinë.*

Me emrin **dasmë**: *premë dasmën; lamë dasmën; hapet dasma;*

Me emrin **sy**: *ka rënë në sy; ka marrë më sy; i mbetën sytë;*

Me foljen **pres**: *prenë ditën; prenë dasmën; premë llafin.*

Me foljen **lidh**: *lidh fëmijën; e kanë lidhur; u lidhën;*

Me foljen **shtie**: *mos e shtiesh (aborton); e shtënë (e dobët, e takequr në pamje).*

Me foljen **zë**: *zë logorinë; zë vajin; zë çupën; e zuri me një tjetër; e zuri (e përdhunoi).*

Figurën e metaforës folje e hasim edhe në shprehje dhe fjalë që përdoren për të emërtuar fejesa, si: *u mbulua, u mbarua puna, u ndërtua, u mpleks, u kumandar, u zu.*

Po kështu edhe koha për fejesë jepet me shprehjet që kanë për bazë figurën e metaforës folje, p.sh. *i erdhi vafti, i erdhi koha, u arrinë.*

Gjithashtu, njihen edhe raste të metaforës emër (katakreza), p.sh. në rastet e emërtimit të fëmijës së vogël: *dhuratë e Perëndisë, peshqesh i Zotit, mjaltë i mjaltit*, të cilat s'mund t'i quajmë sinonime të qëndrueshme, sepse përdoren në kontekste të caktuara. Këshu, me shprehjet *dhuratë e Perëndisë, peshqesh i Zotit*, fëmija vlerësohet si diçka e pafajshme dhe e pavetëdijshme për ardhjen e saj. Ndërsa, shprehja *mjaltë i mjaltit* përdoret zakonisht për të treguar dashurinë e madhe të gjyshërve për nipërit e mbesat.

(2) **Metonimia**, përdoret shpesh në ndërtimet e figurshme.

a) *i jap gjji; i vë gjirin; e heq nga gjiri* (fëmijën).

b) për justifikimin e një martesë të dytë, në raste kur ka ndodhur një fatkeqësi, si:

martoi hallin (=s' u martua nga dëshira);

e do shtëpia (=martesa është e domosdoshme);

e kërkon shtëpia (=martesa është e domosdoshme);

duan fëmijëkat çati (=duan fëmijët familje).

c) metonimia përdoret edhe në disa shprehje me karakter etnografik, që lidhen me rite të caktuara:

vete në të parë (kur nusja shkon për herë të parë pas martesës në shtëpinë e prindërve);

e presim me tavolinë (e presim me drekë);

mori pasurinë (kur martesë bëhet me interes);

hyn në magje (fillon të gatujë) etj.

Duhet të theksojmë se edhe në rastet kur shprehjet janë të figurshme, qoftë metaforike, qoftë metonimike, ato përdoren edhe si çifte të tipave që i konstatuam më lart:

(1) Çift me dy shprehje të figurshme p.sh.:

E donte shtëpia, deshën fëmijëkat çati.

Tani të erdhi vafti, u arrite, hë, bir!

Dhuratë e perëndisë, peshqesh i zotit! (si shprehje për të vlerësuar faktin që famljes i shtohet një pjesëtar, pavarësisht se ç'gjini ka fëmja).

(2) Çift që formohet nga një shprehje e figurshme dhe një fjalë a tog neutral:

E vendosën, *prenë ditën.*

E fejuam, *u mbarua puna.*

Qau, *zuri logorinë.*

9. PËRFUNDIME

Ky fakt ligjërimor (i parë nga këndvështrimi sociolinguistik) lidhet me një bashkësi etnokulturale konkrete, pikërisht me bashkësinë etnokulturale të Korçës dhe rrethinave të saj që dëshmon diversitetin e sjelljes gjuhësore të kushtëzuar nga faktorë natyrorë si: mosha, gjinia, grupi etnik dhe nga faktorë shoqërorë: klasa ekonomiko-shoqërore dhe niveli i arsimit.

Mbështetur në shembujt e mëlartëm të shprehjeve metaforike, njësave frazeologjike,

eufemizmave, mallkimeve të organizuara në çifte, në strukturën sintaksore i japin ligjërimin **statusin e një kategorie të veçantë të të folurit, që i përket grupit shoqëror të femrave.**

Përmes kësaj karakteristike të qenësishme të të folurit, folësit synojnë të kenë një ndikim të fortë te bashkëbiseduesi. Natyrisht, kjo dukuri në mënyrë të pashmangshme lidhet me konservatorizmin në gjuhë e për pasojë edhe me ruajtjen e vlerave të mëdha të gjuhës së gjallë të popullit, që dëshmon origjinalitet e autencitet. Këto ndërtime kanë një denduri të konsiderueshme përdorimi në grupmoshën e vjetër dhe, kryesisht, me nivel të ulët arsimor.

Me interes është fakti që rreth 85% e këtyre shprehjeve njihen edhe nga grupmosha e re, por në shumicën e rasteve nuk përdoren për “konformizëm”, për të mos u paragjykuar për nivel të ulët kulturor nga bashkësia shoqërore ku bëjnë pjesë.

Në këto raste që shqyrtoam, mund të themi se në ligjërimin e folur, përdorimi i çifteve frazeologjike përbën një **teknikë ligjërimore** që:

a. krahas domethënies referenciale, mesazhi, në mënyrë absolute, bart edhe të a.q. **domethënie joreferenciale**, e cila lidhet me shfaqjen e gjendjes shpirtërore, me përzgjedhjen e një kodi të caktuar, me organizimin e brendshëm që u bëhet këtyre thënieve, natyrisht edhe me faktin se çfarë synohet të vilet nga bashkëbiseduesi (destinari);

b. të gjitha këto veçori ligjërimore i hasim kryesisht tek femrat, gjë që vërteton ekzistencën e **ndryshorit sociolinguistik gjini.**

c. ndryshori gjini vepron i lidhur ngushtë me ndryshorin moshë dhe arsimim.

BIBLIOGRAFIA

BAINBRIDGE, F. (1994), Sex Differences: “*Encyclopedia of Language and Linguistics*”.

BERRUTO, G. (1975), *La sociolinguistica*, Zanichelli, Bologna.

BLOM J. - GUMPERZ J., Fattori sociali determinanti del comportamento verbale: “*Rassegna italiana di sociologia*”, vol. IX, nr. 2.

BRAUMAN, R. - SHERZER J. (1977), *Eksplorations in the ethnography of speaking*, Cambridge University Press.

CARDONA, G. R. (1976, 1985), *Introduzione all’etnolinguistica*, Societa editrice il Mulino, Milano.

CARDONA, G. R. (1989), *Dizionario di linguistica*, Armando Editore.

CIREZE M, A., (1989), *Cultura egemonica e culture subalterne*, Palermo.

COUTHARD, R. M. (1980), *An introduction to Discourse Analysis*, London, Longman.

DITMAR N. (1978), *Manuale di sociolinguistica*, Bari La Terza.

DOJAKA, A. (1969), Disa ndryshime në lidhjet martesore pas çlirimit: “*Studime historike*”, nr. 4.

FASOLD and SCHITTRIHN, (1969), *Language Change and variation*, Amsterdam.

FISHER J. L. (1958), Influences in the chois of Linguistic Variant: “*Word*”, f. 14-47.

FJALË TË URTA TË POPULLIT SHQIPTAR (1980), Tiranë.

FJALOR ENCIKLOPOEDIK SHQIPTAR (1985), Tiranë.

FJALOR FJALËSH E SHPREHJESH POPULLORE (1980), Instituti Albanologjik, Prishtinë.

FJALORI I GJUHËS SË SOTME SHQIPE (1980), Tiranë.

FJALORI I GJUHËS SË SOTME SHQIPE (2002), Tiranë.

FJALORI I GJUHËS SHQIPE (1954), Tiranë.

HUDSON R. (2002), *Sociolinguistika*, (përkthyer në shqip nga M. Ymeri), Tiranë.

HYMES D. (1962), *The ethnography of Speeching*.

SHKURTAJ, GJ, (1999), *Sociolinguistika*, Tiranë..